

8SH-1
L 87

FERIK LIZAJ

4

BETEJA

^e
Ngadhnjime

891.983-1

L 87

FERIK LIZAJ

28673
13265

S

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

BETEJA E NGADHËNJIME

(VARGJE)

ipravat, redaktori i titujshëm
dritor i redaktores shtetit

20-NOV-1960 — 08.10.1967 — 08.11.1967
N.S.H. BOTIMEVE «NAIM FRASHERI»
Bashkia — Gjirokaster — Shqipëri — TRANE, 1960

ЛАНД МИХАИЛ

СИМВОЛИКА И АНГЕЛЫ

СЛОВА

Redaktor: Nasho Jorgaqi
Piktor: Ksenofon Dilo

Tirazhi 1000 format 78 x 109 1/32 Stash. 2204-55
Shtyp. N. I. Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

NË SFERAT MË TË LARTA

— Beteja e ngadhiënime —

Mbi shekuj, në luftë, fitorja shkëlqeu
Kur shtigjet e reja Partia na rrëfeu.
Partia, pér ne gjithë me shpirt e shtrëjta nënë
Qe shpata, që shqeu tej me një të rënë
Nga rrënjet t'hatashmen nyjë të mjerimit,
Ku rrugët e jetës pér ne ishin zënë.
Gëzimi — diell' i zjarrtë mbi ne: Partia,
Që shekuj me radhë kërkoi vegjelia
E vet ajo e lindi prej gjirit vigan
Kështu përmbi tokën u thur madhështia.
Parti, a popull — no popull, a Parti —
Jan' një, si dhe zëmra me gjoksin që ke ti.
Parti ësht' kurora e lavdis' s'atdheut,
Partia ësht' e arthmja, që vjen në stoli.
Ajo ësht' gjaku m'i dlit' i zëmrës sonë,
Ësht' vet drit' e syve dhe rrezja, që gjithmonë
Na ndrit neve mëndjen. Kudo ësht' Partia,
Ku paqja ka selinë, burimin dashuria,
Ku jeta stoliset në breza ylyberi,
Ku fronin e vërteta e ngrë dhe sundon
E sherri dridhet t'avitet e s'guxon
Dhe kot ligësia, me mshikëza vreri,
Nga lark na kanoset, dergjet e rënkon.

Me radh' mijra vjetë, si sot dhe më parë,
Ku na po jetojmë jetuan shqipëtarë:
Të parët tan' ishin, që na shum' i çmojmë,
Lavdi, under e famë nga 'ta trashëgojmë;
Veç kurrë nuk pati pér ta drit' e ar,
Mbi tokën e bukur s'lulëzonte bar;

Ata mbetën zhveshur nga çdo pasuri,
Kur zémér' e dheut ngarkohej flori.
Po sot që Partia na dha krah' e fletë
Dhe peshën e jetës dërmoi pér jetë,
O! ç'tinguj ballsami magjishëm kumbuan:
Arterët e fjetur, çudi si u zgjuan,
Në çdo frymëmarrje goditën fuqishëm,
Në çdo molekulë gjak fjesht t'ri vërshuan;
N'agimin e bukur të ditës së re,
U çeln' zëmrat tona e nektar buruan.

Na skeptre rrëzuam, kurora dhe frona
Dhe sot grusht' i ynë si një mal u rrit:
Një forcë kollose përbimi viset tona,
Sa shkul edhe malet e n'er' i vërtit.
Pér ne, gjiri tokës s'sësh' thesar i fshehët,
Na kyçet e zëmrës virgjine ja zbërthejmë
Dhe çdo pesh' e jetës na ngjan aq e lehët.
Sa malet si shqipja me krah' i rrëmbejmë.
Na presin vërtetë bëteja madhështore,
Por aq më krenarë do jemi pér fitore.
Mbi kyçet e jetës sot lufta do zjejë,
Se s'ka ngadhënjime pa luft' e betejë.
Dhe ja, shikoj unë nér t'yjve rreze t'arta,
Si ndizen zjarr më mijra agime,
Që ndrijnë në reflekse sferat më të larta.
Ku na po marshojmë: — bëteja, ngadhënjime!

NJË FJALË

Partia: një fjalë! po mijra pakufi
Për të s'na thonë sa kjo fjalë: Parti
I thur ti poemën pa shoqe, gatuar
Me zjarr e me ndjenja, tinguj të kulluar,
Skalit epopen' e ndritur madhështore,
Për shekuj mbi tokën i ngre përmendore,
Në vargje panumur i këndo lavdinë,
Por zbehen të gjitha, bjerrin madhështinë,
Kur na pa buçitur, thjeshtë e pa stoli,
Një fjalë nxjerrim vetëm nga zëmra: Parti!

Partia: fitorja m'e ndritur, epopeja,
Kur na në vargje dhe tinguj i këndojmë,
Lavdinë, q'ajo vet e thuri nér beteja,
Në vrullin e jetës, që na po krijojmë.
Me driten e saja, që buron e dlië
Na vetëm brumosim, gatuajm' e çlirojmë
Sot mëndjen e zëmrën që patëm n'errësirë,
Ndërgjegjen e madhe të jetës ndriçojmë.

Ç'I RRËFEN FLAMURI ERËS

I.

Rreh flamuri palë e valë...
Si të kishte gjuh' e gojë
Ligjëron kushdi sa fjalë,
Shtrohet era ta dëgjojë.

Ç'i rrëfen flamuri erës
Sot për netët e homnerës?
Ca legjenda partizani,
Zëmër hekur, dej luani,
Gji barot e fli vatani
Gji vigan: stoli mejdani.
C'historira vark e sërë:
Epopen e luftës tërë.

I di era, që ka rëndur,
Me flamurin palë ëndur,
Ajo vet i pa të gjalla
Jo legjenda, jo përralla,
Po nisira me kokalle
Trimash, syrin presë palle,
Përmbi gjakun, si një det,
Që ngrë vala dhe buçet...
Dhe rrëngjethet nér kujtime,
Kur dëgjon nga pala trime,
Pala drif' e gjak e ngjyer,
Pala n'er' e rrëkëllyer,
Historin' e Partizanit.
Shtyll' e hekurt e vatanit.

Rreh flamuri dhe shkëlqen
 Erës ngjarjet i rrëfen;
 I rrëfen, si vet' ai
 Asnjë ditë s'ra në zi
 Po u ngre me trimëri
 Dhe në krahun e Partisë, —
 Zëmr' e madhe e vegjëlisë —
 Dha kushtrimin e lirisë:
 «Bijt e shqipes sa që janë
 «Mbi xhelat e mbi tiranë».
 Dhe ahene mijra trima
 Sy shkëndira, vetëtima,
 Nëpër gjakun e çlirimt,
 Ngjyjen palat e kushtrimit,
 Që nga gjaku i Qemalit,
 Te Perllati, drër' i malit;
 Që nga Vojo gji vigani:
 Teh i rrepët jatagani;
 Nëpër burgje gojë shpellë.
 Nëpër ishuj gjire thellë;
 Nga terrori rrugës Kus.
 n'orizonte tym e püs,
 Në trekëmbshet e xhelatit.
 Tek dragojt e Piskopatit,
 Tej në krisma nëpër male.
 E pastaj fill e ngadale
 Zjarr' i ndezur, si rrufeja
 Në përleshje, në bëteja,
 Në bëtejat e çlirimt,
 Gjer te grushti i ngadhënijimit.

E di era, që ka rëndur
 Me flamurin pala ëndur
 Edhe bie nér kujtime.
 Kur dëgjon nga pala trime,
 Pal' agimi, drit' e ngijer,
 Nëpër gjak e rrëkëllyer,
 Historin' e parrëfyer.

III.

Ky flamuri në shkëlqim,
Që dha nam e zë në botë
C'i rrëfen e s'ka mbarim,
Erës, qielit, çfar i thotë?
— C'i rrëfen ashtu, flamur,
Mbi krahina shkrumb e zhur,
Mbi çdo lënd' e mbi çdo gur
Që po rrjedhin gjak dragojsh
Kundër çdo vargan vargojsh

— I rrëfej si robëria
Na u shporr, nga Shqipëria.
Si na erdhi nga Kremlini
Rrezje ngrohët e liria,
Si shkëlqeva në fitore,
Ku më ngriti vet Partia.

IV.

Për lavdinë, që na pruri,
Për legjendat, që na thuri,
Rreze yjesh ky flamuri,
C'i thot erës gjë më gjë?
— Er' o erë pakufi,
Shko dhe botës i rrëfe,
Kudo popujve mbi dhë:
Se flamur' i Shqipërisë,
Që shpall dritë bukurie,
Mba në palat e lirisë
Gjak bëtejash vegjëlie.
Dor' e hekurt e Partisë
Më mba lart me krenari
Dhe më shpie nga fitorja
Në fitore, në lavdi.

M.

Nëndor, 1945

KËSHTJELLA E KRAHARORIT

Një mbrëmje: Nënt' Tetori, një natë, që rënkon
Dhe yjtë stoli — qelli për toke i rrëzon,
Si pika lot' që ndrijnë me zjarr e xixellima,
Nga gjiri thell' i shkundur nér «ah!» e pshëretima.
Po ç'ka që po rënkon kjo nata zëmër zhur?
Rënkon se do të pjellë legjendën, që po thur.

Kur zbret agimi cohë në gjak i zbukuruar,
Dhe dita bie yllin me zjarr kurorëzuar,
Tirana e përgjumur, që flinte si një varr.
Po shkrep tani nga gjiri shkëndira tym e zjarr.
Në natën që na ëndi pëlbur' e zezë sonte
Tre burra luftëtarë armiku po rrëthonte,
E trimat po luftojnë rrezikun pa peshuar,
Fashista më çdo anë shtëpin' e kan' rrëthuar;
Ordhira kundër treve një shtek më s'kanë lënë,
Kërkijnë me çdo kusht t'i vrasin, a t'i zënë,
Por kot: aty qëndrojnë me zëmra ndezur prush,
Dragojtë Stavalec, Martin e Vojo Kush.

Rrëthimi i armikut u shtua dy-tri herë
Dhe lufta egërsohet; në zjarrin e paprërë
Tirana po lëkundet në flak' e tym mbështjellë.
Po s'tundet zëmr' e trimit, qëndron si një kështjellë.

Aty tre luftëtarët sulmojnë më guxim,
Ata kërkijnë shpagë në zjarr e vëtmohim,
Ata kërkijnë shpagë për shokët, që u vranë
Mbi tokën shqipëtare të skuqur anemanë.
Shikojn' ata një popull t'uritur e irrekosur,
Me flakën e urrejtjes tiranit armatosur;
Kujtojnë Qemal Stafën në brigjet e Tiranës,
Që ra si një luan me flakën e lirisë,
Perllatin në qytetin e vjetër të Bujanës

Zvarrisur nëpër flakë: hero, simbol i flisë.
Dhe ndizet zëmr' e tyre, hakmarrje po kërkon,
Me gjoks Vojo Kushi mbi tankun po sulmon,
Kërkon të hyjë brënda për drithmën e barbarit,
Por hovin ja këput — ah! — plumb' i tradhëtarit...

E trimi po rrëzohet, si yll në hapësirë,
Mbi tokën e stolisur me gjak e me martirë.
E ja, dhe Stavaleci e Martini aty ranë:
Tre yje u-rrëzuan mbi tokën pran' e pranë.

Gojdhanaq që na kemi, legjendat aq të rralla,
Me gjak të kuq kreshnikësh i shohim sot të gjalla.
Oh!... ra kjo zëmr' e trimit, u la në banjë gjaku,
Po lart' e ca më lartë, si yll u ngre bajraku.
Kështjell' e kraharorit e kreu çdo detyrë
Dhe flë, si flë vullkani, që zjarrin e ka shfryrë...

Tani nér kaq stoli u mbyll legjend' e rrallë.
Më von e nëpër stinët e shekujve vërdallë
Çdo mëm' e vëndit tonë do nisë një përrallë...
Se populli për jetë në zëmra do skalisë
Figurat e heronjve, si yje të lavdisë: —
«Na ishin e na janë tre shokë kordhëtarë,
«Tri zëmra çelike dhe qindra barbarë...»

Kështu ajo tregimin fëmijve do t'ua — nisë
Në dimër, afër zjarrit e netët do stolisë...
Me lotë nga mallngjimi në heshtje do mbarojë
Dhe prap ajo me bindje e krenari do shtojë:
«Dhe sot e kësaj dite akoma janë gjallë,
«Në botën shqiptare, ku sillen sot vërdallë,
«Heronjt e 10 tetorit me flakën e lirisë,
«Ata që dje shkallmuani vargojt e robërisë
«Dhe vet gjakun e zëmrës me gaz ata mohuan,
«Dhe gaz e lumtëri me gjak kurorëzuan,
«Mbi botën shqiptare, që vet ata ndërtuan.
«Në gojën tonë t'artë, që thur lavdin e rrallë
«Kreshnikët e legjendës akoma janë gjallë»

Fëmijtë, qé dëgjojnë me dhëmbj' e krenari
Do pyesin ahere të kredhur në habi:

«Po ku janë vallë
«Trimatë me pallë?»

Sa her' ata më von do rrinë t'ëndërrojnë
Në gjurmat e heronjve me etje të kalojnë
Krenar' e ballëhapur, q'atdheut e Partisë
Me vepra t'i skalisin kurorën e lavdisë.

Cermenikë, Mars 1943

NË VARR E NË TRIUMF¹⁾

I rrëzuar shtati yt!
Gjaku plagët po t'i mbyt...
Si rrufe, si teh hanxhari,
Gji barot e fli alltari,
Gji granit: tmerr i tiranit,
Re në ballin e mejdanit.

Ja dafina, ja kurora,
Stoli lule, si dëbora.
Paqe, prëhje: heshtje varri,
Ku flë gjoksi lava zjarri.

E, si shokët të mbuluan:
Balt' e gurë të ngarkuan,
Lule e gjethë të stolisnë,
Për në luft' ata u nisnë.

Kur e panë, se të lanë
Dhe nga ti për jet' u ndanë,
Oh! nga zëmra gjak pikuan
Edhe thell' ata rënkuani
Për një yll e trim me fletë,
Ballë gjak e faqe zbetë,
Për hakmarrje u betuan
Lark, si shqipet fluturuan.

Kur dëgjove arm' e shokë,
Që të lan-o për nën tokë
Dhe jehonën e rënkitit,
Që ndes plagët e trishtimit,
Pse rënkoive thell' e rëndë,
Sa e drodhe gjithë vëndë?

1) I kushtohet një partizani komunist.

Oh! rënkimi yt, o trim,
Qe tërmët e s'qe rënkim,
Qe trumbet' e qe kushtrim:
Duf e zjarr, vullkan në gji,
Të vërvitesh përsëri,
Si rrebesh e si stuhi,
Porsi llohrat e tufanit,
Mu në ballin e mejdani.

II.

Ballin e armikut more
Edhe tej, me bomba dore,
U vërvite në llogore,
U vërvite me tallas
Vet' i par' e katër pas...
Dhe at'herë se ç'ka ngjarë,
Qielli lart e paska parë:
U drodh vendi anembanë,
Se në luftë si luanë
Ranë pesë partizanë
Plag' e gjak mbuluar shta' në!...

* * *

Bje buria, sa gjëmon
Dhe brigada po sulmon;
Po sulmon Brigad' e tretë:
Trima, që përpijnë retë.
Nisi sulmi: shokët trima
Turren harqesh vetëtima!
Shok' e shoqe, drëj e drëra,
Sy dragoj e shtate zëra...
Hajde, ç'drëj ka pjellë nëna!
Hajde, ç'zëra gjykëzëna!
Ç'shoqe trime kapedane,
Ballë hëna në mejdane — !...
Nisi sulmi: shokët trima
Turren harqesh vetëtima,
Pa të gjetën e të panë
Nëpër gjak të mbytur shta' në...
Flamur

C'ju the vall — o ti n'at'orë?
C'ju rrëfeve ti me dorë?
Asnjë plag' e asnë dert,
Po me ballin sert-e-sert
Dhe me fjalën vërshëllyer,
Nëpër gjak i rrëkëllyer,
Mu në gjak mbërthyer gjurin,
Sy mbërthyer mbi flamurin
E me dorën nyje hekur,
Përmbi hekur të përpjekur,
T'ëndur krahun e çelikun,
I ndërseve mbi armikun:
«Shokë, turru-ni në ballë!
«Këtu na kërkon Partia:
«Sot armik asnë të gjallë!
«Të varroset tirania!
«Ja fitorja... ja armiku,
«Bini me gjokse çeliku».
E, nga kjo tok' e bekuar, —
Që të mba në kraharuar,
Si stoli, dëshmi të çmuar; —
M'i dhe shtatit e mbi gjak
Ngule pahun, si bajrak!
Ënde form' e ënde hie, —
Stuhi hiesh: vruj stuhie:
Form' e rrepët krenarie! —
Edhe tej, tek ndizej fronti,
Sa përgjakej horizonti,
Ti, si tehu jataganit,
Ré në ballin e mejdanit.
Formë çthurur gjak e plagë,
Zëmër thurur zjarr për shpagë,
Gjak e zjarr kurorëzuar,
Gjak e zjarr në kraharuar,
Mortje hekur ti në duar,
Fill e flak' e vetëtimë
Nëpër gjëm' e uturimë,
Me të tjerët u vërvite.
Tek e para vijë zbrite.

Tek^{te} para vijë zjarri:
Gjak e hekur: shtresa varri.
Dhe mbi varrin, si kapak,
Kafka, kurme, kërm' e gjak!
Edhe zbrite rreze drite:
Ndrite trim, o yll-o ndrite
Zjarr e flakë llamburite,
Bumbullite... e, vetëtite,
Porsi ylli më të dalë,
Shtati plag' e gjaku valë,
Trim o yll-o trim o djalë!
«Përpara!» shokëve brite
E nga plumbat u godite
Mu në zëmrën palë-palë...
T'u këput oshtim' e fjalë...
U godite... e re, si yll
E, si flaka nëpër pyll,
Që ndes zjarrin mbi çdo lëndë,
Ndeze shokët hie rëndë!...

III.

Dhe nga thundr' e Partizanit,
Që shemb kampin e mejdanit,
Shembet krejt flamuri-flamë
I barbarit kërm' e dhjamë...
Rënd armiku ka-dyrdyl...
Me flamurin gjak-idol
Të mbërthyer në bërryl,
Ti, në heshtje i rrëzuar,
Ndjek armikun të tmerruar,
Se, mbi hekur, zëmër hekur,
Iu kanose, duke vdekur!
Gjak e gjokës i rrëfeve:
Zjarr e hekur i ndërseve!
E ndërsa si yll u shove
Vdekje ti mbi 'të dërgove
Edhe ënde mbi llogore
Një flamur e një fitore.

MBI GJAKUN E DËSHMORIT¹⁾

I.

Er' e trëndafilit, luleja me fletë
Si m'u have vallë pa koh' e për jetë?
O yll i këputur që nga zëmr' e jetës,
Bir' i idealit, zëmr' e së vërtetës,
Ti sorkadh' i malit, drëri vet i pyllit
Ku ma humbe gjurmën, mu si gjurm' e yllit?...
Vallë, ku je fshehur? Vallë ç'të ka gjetur?...
Mu në gjin' e varrit ti më rri pështetur,
Buzën më të qeshur, syrin të dremitur,
Flak' e zemrës sate kurr' e paventur!...
Nga më paske rarë, ku më qënke futur
Brënda n'errësirë, o yll i këputur?...
A s'më thua vallë, ku e shkon risinë
Në çdo dit' e muaj në çdo or' e stinë?...

II.

Mbi banesën tënde reja të shkarkon
Erën me rrebeshe, erën që vajton.
I dëgjon ti erës vajin e xhindosur
Nër shkëmbinj e shpella gurëve gjakosur,
Grykave dhe pyllit lëndë mazgallosur,
Lyer vala gjaku, ku rigjën kujtime
Dhe rënkon e dridhet nëpër ligjërimë,
Ulëret e ndizet nëpër fishkëlliime.
Pa këndon në këngë me gjëm' e me valë
Gjakun e heronjve zëmra shtatë palë.
Këng' e saja, klithmë, ndizet n'imtim,
Porësi, gjëm' e luftës ndezur me tërbim,
Ku me qindra herë shtyllë partizanin.
Pa, me gjoksin shkëmb, ta çliroj' vatanin.

1) Në kujtim të shokut Jorgji Dilo, komunist, shok shkolle
dhe luftë. U vra duke luftuar kundra forcave mercenare të Xhaf
Balit, ne rrethet e Elbasanit, Gusht 1944.

III.

Vëlla, sa kujtime në zëmër po ruaj!
 Mallin, që më digjet dua që ta shuaj,
 Po fjala nuk mundet plagët t'i shërojë,
 E q'ndiej un' në zëmër as thuhet me gojë:
 Fjala është gjëm' e valëve të rënda,
 Gjëma del përjashta, vala zien brënda.
 Vëlla, që m'u shëmbe, si një yll me rrëze
 Dhe me flakën tënde hapësirën ndeze.
 Plumbi i tradhëtarit jetën ta rrëmbeu,
 Po nga zëmra jote mori jetë dheu...

IV.

N'ëndërrat e tua, nat' e ditë brënda,
 Cila ësht' m'e bukur? Cilën të ka ända?
 Cila këngë m'ëmbël n'ëndërr të përkund,
 Si dëshira jote, që s'ka an' e fund?
 Kënga e heroit, q'e lufton armikun
 E me gjak e hekur i këlliet panikun,
 Kënga, që ngrë lartë kundër tiranisë,
 Fron' e së vërtetës, yllin e lirisë,
 Trimin, që me jetën, po lufton pér jetë.
 Po!... dhe aq e ëmbël, sa dhe jeta vetë
 Në liri dhe paqe...

Vëlla!...

...c'qe m'e hidhur,
 Se sa jeta vetë në vargoj e lidhur?

 Trim vëlla, që kurrë më s'ta ndiej zënë.
 Endërrat e tua, sa flë vala flënë...
 Si flë lumi egër vala vërshëllyer
 Nër shkëmbinj e gërxhe gjire rrëkellyer:
 Popull e satrapë janë uj' e zjarr,
 Pér kufi të tyre kanë gjak e varr.

SHKËMBINJ
SHTETI
13265

V.

Sot e lirëjeta dridhet në shkëlqim
 E thërret dëshmorin kredhur n'adherim.
 «Ngreu që nga varri!» «Jeta po të fton,
 «Ngreu ti hero!» populli gjëmon,
 Edhe klithm'e zjarrtë horizontin ngjeth,
 Se nér dejt e ndezur gjaku yt i rrjedh,
 Gjaku vala-prushi. Se frym'e martirit,
 Që pér jet'i theu rrathët e zinxhirit
 I mbush kraharorin, u bë frym'e jetë
 Ndër dej të çdo zëmre, të popullit vetë.

VI.

Ëmbël er' e qiellit èndet në liri,
 Ënd nga gjirijeta gaz e brohori,
 Afsh e zjarr e dritë, paqe, dashuri!
 Ëmbël er' e qiellit èndet pakufi...
 Po nga gjir'i varrit as na thua ti?...
 Të ka dobësuar, tretur errësira,
 Të ka vrar' e lodhur heshtja, shkretëtira.
 Ja! pa ngreu, ballin ja trego pasqyrës!...
 Rrotulloja syrin dritës e natyrës:
 Vështro anembanë qiellin e ndritur,
 Diej, hën' e yje, drit' e pavénitur.
 Q'ënden hapësirës. Shihi pér zbavi
 Kredhur në habitje, si në foshnjéri!...
 Vështro më çdo anë gazin, q'i dhe jetës!
 Vështro, si shkëlqen drit' e së vërtetës
 Që pér 'të luftove, si të tha Partia:
 «Komunist, me gjak lulëzon liria!»
 Dëgjo një muzikë: Melodin e jetës...
 Zëri, melodia, not' e së vërtetës.
 Nota, që të priu kudo mbi tiranin;
 Notë, që në zëmër të ndezi vullkanin

E ta lulëzoi gjî'n e ballin gjak,
Ku stuhit e hies shkundi ky bajrak...
Ngreu! Po ti s'tunde: Shkëmb,
siç i qëndrove
Luftës e rreziqe kurrë nułk peshove.
Flij, pra trim-vëlla, n'ëndërra i qetë!
Flij, se shkele gjurma drite ti në jetë.
Drit' e kësaj Dite, drita m'e kulluar,
Rrjedh nga rrođhi gjaku vala shkumbëzuar.

Elbasan, 15 Mars 1945

1) Në kujtim të shokut Jorgji Dilo, komunist, shok shkolle dhe lufte. U vra duke luftuar kundra forcave mercenare të Xhafer Balit, në rrethet e Elbasanit, Gusht 1944.

DHËMBJE E KRENARI

Mëma vajton djalin e rënë në
luftë kundra veglave t'okupatorit.

Qesqin o zëmër të vranë,
Un' e zeza djalë. 1)

Ata që shesin vatanë.
Vranë trimin presë-palle,
Ca të shitur për kokalle,
Ata, që na bënë trek.
Zëmër pse u re më shtek?
Drita ime: Yll sabahu,

Yll-o trim! 2)

Pallë mëndja, pallë krahu,
Qysh u re më pritë vallë?
Ata zjarr e ti përballë.
Bomba, krisma, batare,
Gjaku shtatit, si rrëke.
Zjarr e plumba nga çdo anë,
Plagë ta stolisnë shtanë.
Ta përgjujn-o shtat'n' e ri,
Mu si drërin në pusi.
Qesqin, vetulla gajtani,
Teh i ndritur jatagani,
Ku m'i pate shokët vallë,
Që të marrin gjak në ballë,
Të ta ngrinin shtatin plagë,
Të vërsuleshin për shpagë?!
Po ti një sa për njëmij
Drodhe ç'qenë hysmeçij.

1) Ky varg përsëritet pas çdo vargu, gjer te vargu i dytë përsëritës.

2) Përsëritet pas çdo vargu.

Shtati plag' e gjaku valë
Drëri malit, trim o djale,
Xhebrailit iu kanose
Dhe me gjokës e karfose,
Siç e ka trimi *Partin*,
Për Partin' e për atdhenë.

(Nxjerrë nga pjesa theatrale: «Mëmë, babë e bir» — 1947)

I

Dje mëmë, mëmë,
Po qendrigjithesh,
I o tħosjan minn,
Siegħi lu qed e fil-hix.

II

Dje mëmë, mëmë,
Po qendrigjithesh,
I o tħosjan minn,
Siegħi lu qed e fil-hix.

III

Dje mëmë, mëmë,
Po qendrigjithesh,
I o tħosjan minn,
Siegħi lu qed e fil-hix.

IV

Dje mëmë, mëmë,
Po qendrigjithesh,
I o tħosjan minn,
Siegħi lu qed e fil-hix.

V

Dje mëmë, mëmë,
Po qendrigjithesh,
I o tħosjan minn,
Siegħi lu qed e fil-hix.

MARSH PARTIZAN

I.

Jemi trima luftëtarë,
Partizanë-çlirimtarë,
Na luftojmë çdo tiran,
Për liri, ndër e vatan.

II.

Dhe me grushte vendimtarë,
Po çfarosim tradhëtarë,
Po rrëzojmë tiraninë,
Sjellim paqen e lirinë.

III.

Sa nga ne në luftë ranë
Trima, zëmëra luanë!
Dhe në gjurmat, që na lanë
Na marshojmë mbi tiranë.

IV.

Bie trumbeta, na marshojmë,
Ndizet lufta, na sulmojmë,
Gjëmon topi e batareja,
Na në flakë, si rrufeja!

V.

Nuk peshojm' asnjë rrezik,
Fill' e flak' mbi çdo armik,
Eshtrat tonë mbjellim vetë
Që të korrim gaz e jetë,

Se nga varret me gjak flije
 Ngrihet lulja e lirisë,
 Ku me gaz martiri bije,
 Dridhet fron' i tiranisë!

Nëpër gjak e mbi çdo shkëmb
 Po valon flamuri lirë
 Dhe barbarin ngjeth e shëmb, —
 Kanibalin egërsirë! —

Ja, trumbeta po na fton
 Për në luftë. Dhe tmerron
 Çdo tiran e tradhëtar
 Hovi revolucionar!

Dumre, Nëndor 1943

shill doja em jenku em
 është a shill e dedikat
NA PRIN PARTIA
 shill doja em jenku em
 është a shill e dedikat

- Ç'ësht' ai, që nëpër male
Flak' e ndez qerpikun?
- Ku urejtja aq e thellë
Digjet për armikun? ...
Është bir' i kësaj toke,
Zëmra e alltarit
E ndjek gjurmat, që ka ndjekur
fis' i Shqipëtarit.
- Çfarë gjurma? ... Përse vallë
Sillet sy shkëndie,
Ngjeshur armët e stolisur
Pamje trimërie?
- Mbron vatanin, ku ka lindur,
Nder edhe liri,
Merr nga Mosk' e Shtat' Nëndorit
Drit' e madhëri.
Mbron me arm' e ngrë flamurin
Malit të valojë,
Tregon botës se barbarin
Di si ta luftojë.
- Ç'ësht' kjo krism' e bumbullimë
Q'e tund ashtu malë?
- S'është krism' e bumbullimë,
Është zë dhe fjalë...
Fjal' e tija është vepër
Q'e drithmon armikun:
Më një krah rrëmben flamurin,
Më një krah çelikun
E ngrë luftën clirimtare
Malit gjii vigan,
As duron padron e turret
Kundër, si luan.

Dhe në vdektë, porsi burrat
Botës i rrëfen,
Se lirinë me gjak zëmre
Ky për jet' ushqen.
— E liria a vjen për né,
Vjen për vegjeli?
— Për ne vjen e do shkëlqejë
Si një yll i ri,
Se në krye prin Partia,
Lum moj Shqipëri!

Cermenikë, Verë 1943

LEGJENDA JONE

— Me ne Lenini, Moska dhe fitorja — (Rapsodi)

E Prëmte, Prill 7: Ndër mëndje kujtimin,
Në zëmër urejtjen na ngjall përsëri,
Në pre dhe në gjak u turr atë ditë
Ujkonj' e uritur e Romës impero.
Mbi ne u ndërsyen aq t'egér valë-valë
Të pjellës s'urryer hordhi me vandalë.

Të rënda fort' ishin ato dit' e netë,
Nga thundr' e çizmes u droth zëmr' e tokës
Dhe populli, q'u hoth në fushën e bëtejës,
Pa qartë n'at'orë të madhen tradhti,
Që kazmën atdheut ja vu' nér themele,
Në gjoks i vu' thikën dhe krrusmën mbi supe.
Pa «krerët», që shkuan kopë dezertorësh,
Po krerë satrapë, hajdut' e plaçkaxhij,
Hejbetë mbi supe me ar e florij:
Një band' që shpërngulet dhe shkon e tmerruar,
Se ja, vjen e dyta, që vëndin t'ja zërë
Dhe pren' e rrëmbyer nga thonjt t'ja rrëmbejë.
Kështu, dje hajduçe, fashizmi erdh' u shtrua,
Si zot i vërtetë në vatrën e huaj
Dhe desh' vëndin tonë ta bëj' kallamé.
Hesapet pa hanxhinë më tym i kishte bërë,
Mendoi: Vëndi shkretë, pa zot në karshi.
Po zot kishte vëndi: ja, prijse Partia,
U ngre mbi atdheun, q'u shkel në vargoj
E thirri: — «Vëllezër! ësht' jona Shqipëria!»
— «Ësht' jona!» — njëgoje tha populli tërë,
— «Ësht' jona!» — buçiti njëzëri vegjelia. —

«Këtu pse na erdhi fashizmi, qën i zi?»
«Bejler' e bajraktarë përsë na e ftuan?
«Fashizmi ësht' i huaj dhe Duçja i fashizmit.»
E foli Partia: — «Na sklev' nuk jetojmë
«Në thundrën e urryer. Më këmbë për liri!
«O burra! Erdhi dita! ja, fundi kanibalit!
«Për sherr ky dje lindi në Rom' e Raihshtag,
«U maj i hatashëm mbi popuj ndërsyer
«Dhe sot po varroset te Mosk' e Leninit.
«Ta shporrim vëllezër, ta hedhim në det:
E populli ushtoi: «Ta hedhim në det:
«Ta shporrim kuçedrën, që na zu vatanë.
«Na shpatën të xhveshur për jet' kemi pasur
«Dhuratë për armikun nér beteja hasur,
«Kudo në përleshje gjoksin i rrëfejmë
«O burra, ne armët sérish t'i rrëmbejmë.
«Na pjella vet jemi e burrave azganë,
«Na pjella vet jemi e námít në botë,
«Me gjak e me zémër kreshnik'sh u gatuam,
«Na jemi të fisit, që bëri çudira,
«T'atij Skënderbeut, që botën mahnitit,
«Kur burrat shqiptarë, kala e pathyer
«Me gjokse iu bënë Evropës zë madhe,
«Që dridhej nga tmerri n'yrysh t'osmanllive
«E dot n'kathedralin Shën-Pjetër të Romës
«Fatihu» asaj kohe tagji nuk i vuri
«Ngadhnyses atllarit, ashtu si pat thënë.
«Na jemi t'epopesë q'Evropën më këmbë
«E ngriti» në vitin nëndqintenjëzetë
«Dhe valle i këndojmë Selami Salarisë
«Na jemi t'Naimit dhe Rrapo Hekalit
«Çerçizit, Gramenos. Kelmendit e Currit
«T'Avniut na jemi dhe mijrave burra.»

E prap' tha Partia: — «Shikoni nga Moska,
«Ku yll' i fitores për ne po shkëlqen:
«E rënd' është rruga, për ku po marshojmë,
«E madhe fitorja, që na do gözojmë.

«Armiq e tradhtarë beteja do përlajë
«Dhe malet e fushat në gjak do t'i lajë,
«Po diell' i Kremlinit mbi ne do ndriçojë
«Dhe shpejt dit' e bukur për ne do t'agojë.»
«E populli gjëmoi: — «Na prij o Parti!
«Na jetë më s'kemi, pa buk' e liri!
«Me tyj na në flakë, në dallg' stuhi!
«Të rrojë për jetë kjo Moska emër madhe,
«Të rrojë për jetë Parti e Leninit!
«Na jemi të Partisë, që lindi për ne,
«Nga vet zëmra jonë: Partia na prin.»
— «Përpara! — buçiti m'at'here Partia. —
«O burra! erdhi dita: — ja, fund' i kanibalit!
«Flamuri Leninit na prin nér beteja!
«Me ne sot Lenini, Moska dhe fitorja!»
«Dhe fjala anemanë flamur e kushtrim
U hap shpejt e rëndi, gjëmoi si rrufe:
— «Përpara! erdhi dita: ja, fund' i kanibalit!
«Flamur' i Leninit na prin nér beteja
«Me ne sot Lenini, Moska dhe fitorja!
«O burra ne armët dhe gjakun rrëke!»
Dhe gjaku vërtet-o rrëke që kulloi,
vërshoi mbi tokë nga zëmr' e Qemalit,
Simbol vëtmohimi u ngre mbi Bujanën
Figur' e Perllatit, e zjarrtë përmes flakësh
E tanksit, që turrej, kollose iu ndërsye
Tetor dita dhjetë¹⁾ me gjoksin kala.
Dhe populli i téré nj'armat' e pathyer
Marshoi betuar: «Hakmarrije e fitore!»
Flamuri u ngre lartë i kuq e krenar
Në tymin e luftës e gjaku më gju
E zjarri më quell u ngre mbi gërmadhat.
Trekëmbshe dhe burgje, xhelat' e gardianë
Kudo përmbi tokë — kërdi, kasapanë,
E ballas, kapërthyer më gjokse t'armikut,
T'etuar për lirinë mbi trojet e rrenuar,
U ngremë luftëtarë të nxir' e të rrepët,

1) Dita dhjetë Tetor 1942, kur heroi i popullit Vojo Kushi iu turr me gjoks tanksit, q'i turrej.

Si flaka, që ngrihej dhe tymi gjer në qiel.
Nër avujt e gjakut u mbyt er' e lirë,
Rënkoj 4 Shkurti e gjak pikuan yjtë,
Nga klithm' e Borovës u çà hapësira
Dhe malet u krrusnë, u droth zëmr' e dheut,
Nër shtat' palë qiej u ngre uturima,
Po trimat qëndruan aty shtatë zëmrash.
Dhe vetëm flamuri, që çante stuhishëm
Të gjitha stuhitë, që shkundeshin n'erë
dhe hiet e kaosit, si çan vetëtima
Të zezat re sterrë, si zjarr shkrepëtinte
dhe digjte errësirat e natës thëllimtare...
E priej, n'agimin e bukur, ngadhnijes...

Ujkonjat e Romës, hordhit e Raihshtagut
Me radh' erdh' e lanë lëkurën dhe ashtën
Në tokën arbrore, si breshka te nallbani.

Hatashëm râ shpata e Moskës mbi kuçedrën,
Që popujt e botës u turr, aq llahtarshëm,
Goj' zgavërr t'i gllabrojë, dhe rrashtën ja çau.

Ahere lart u ngrenë, mbi botën që ziente,
Më lart e në qiej, flamujt e lirisë,
Shkëlqyen, si rrezja armët e lavdisë,
U çan' ret e zeza, u resht dhe rrebeshi,
Kurora dafinash u thurnë nér popuj
Dhe dielli fitores mbi ne buzëqeshi.

Kështu, nga Kremlini në trollin shqiptar,
Flamur' i Leninit u valvit krenar
Dhe populli tèrë një zëmr' e një gojë
Buçiti: «Fituam! Lavdi na Partisë!»
Pa foli Partia: — «Lavdi tyj, o popull,
«Që je i pashterur burim i fuqisë.
«Në luft' mbi armikun vigan krahu yt
«Qe zjarr i rrufesë, që shkrep e stuhi
«Dhe gjoksi fuqishëm një mal, që nuk krruset,
«Nga moti që shkundet shtërgat' e furi.
«E vet zëmra jote minier' me flori.

«Nër shekuj krijove legjendën pashoqe
«Dhe ballin e ndrite me nder e lavdi.
«Rrëzove ti nulla dhe skeptër e frona,
«Tani skllav i djeshëm sundon mbi atdheun:
«Je zot i fuqishëm në tokën, ku linde.
«Të rrosh ti sa malet o popull mbi dhe,
«Me atë zëmrën tënde të gjérë si deti,
«Me shpirtin e ndritur, të bukur flori,
«Me mëndjen e thellë, të madhe krijuese.

«Tani po të presin bëteja të ra,
«Një vepër e madhe pret duart e arta.
«Na rrugën po marrim me vrull e guxim,
«Një rrug' e parrahur, e re që na shpie
«Në prëhër të jetës, nér gjij begatje:
«Na drejt socializmit tani do marshojmë
«Ja, tokat e gjëra, që ndëhen pjellore,
«Me dorën krijuese ato lulëzo;
«Ja, thellë në tokë, burime thesaresh,
«Me krahun sundonjës ti vet i pushto;
«Ja forcat e fshehta t'natyrës së virgjëra
«Me forcën e mëndjes i ndrit e sundo».

— «E populli ja ktheu: — «Me ty o Parti
«Na ret i përpjimë dhe bëjmë mrekullinë.
«Na prij si gjithmonë në rrugën e ndritur,
«Me ty na mbi tokë do ngrëm' madhështinë.
«Për shekuj pa numur të rrosh o Parti!»
— «Me ty bashk' o popull dhe Moskës lavdi!
«Nga Moska kreshnike na erdhi liria,
«Atdheu Leninit pér jet' të na rrojë,
«E zëmra miqësis' pér jet' t'i këndojet!»
— «Pér jetë pambarim!» — ushtoi vegjelia.

Tiranë, shtator 1956.

Vëlla, aq që turi dëshirën më mëdha, si që
Dridhet e idha qëndrur, që (Lëvizja e shtetit) vëllëruan më
Më gjithë përfshira që vështor, që zbaton, që "Një (një) është
Vëllëruar". Në Shqipëri është i vërtetë që mëdha që
Vëllëruar.

VELLEZËR TË NJËJ FATI *)

— Të ftoj vëlla —

I. Të ftoj vëlla si fitellë që mëdha që

Si gjethja, që lëkundet e rrahur në një shqotë,
Si varka në liqeje, si syri nëpër lotë
Të dridhet zëmra jote, lundron në vaj e zi;
Por shpesh ajo edhe ndizet, si deti me furi
Në zjarrin eurrejtjes s'egër pa kufi.

Vëlla, si ti dhe unë, na jemi të dënuar;
Peshojmë vargje-prangash mbi gjoksin, q'u kalit
Në farkën e çlirimt¹⁾ prej shekujsh e pashuar;
Nër dallgat e stuhive qëndrojmë si granit.
Na vuajmë nën kanxha të jetës pa mëshirë
E rrahim t'i coptojmë me dhëmb' e me thoj,
Kur qesh tiran-xhelati në gjak, si egërsirë!...
Kur qesh... por edhe trandet nga sulmet në vargoj...

Në pиргje grima kafkash të skillëve masakruar
Që dridhen e llahtarshëm rënkojnë zëmëruar
Për shpagë, me lava t'urrejtjes së pashuar,
Gjërpj mbi krye flokët ndërsehen, si të ngrirë.
Nër eshtrat, që na therin na rënd një drithtrirë.

*) Kjo poezi u shkrua në Mars 1943 në kohën e okupacionit fashist italian. U ripunua më von pas çlirimt më 1951.

1) Nënkuptohet: Në farkën e çlirimt të luftës për liri.

Dhe ja, vëlla... rrrethuar kokallesh lyer gjak,
Kur thundra timur-lenge¹⁾ me mburrije mbi to shkel.
Më thuaj, vall' a mundet na, qet' e pa merak,
Të presim atë fat, q'ato i përkëdhel?

Vëlla i botës sime dhe motër, mëm' e at!
Na gjithë jemi skllevër e kemi po një fat:
Nga lind e perëndon na kemi një xhelat.

Në hien e pallatit të lart' e fekseplotë
Kasollja e foshnjat tonë na nxijnë vaj e lotë.
Në hien errësirë, që heth mbi ne pallati, —
Ku rri e madhërohet një qënie malukati —
Na, hie përmbi hie, të verdhur e të nxirë,
Po vyshkemi si lulet, që vyshken n'errësirë.

Vëlla, ti zëmërpellënxë në vrer edhe në gjak.
Vëlla, në fatin tim prej shekujsh ti ortak,
Një det, që vala vreri në zëmër të rëndon,
Në gjokës brënda meje, po zjen e po gjëmon.
Nér mijra vargje dallgash, si toka nga tërmeti.
Lëkundet kraharori, kur shfryr, rënkon ky deti.
Kur del përjashta loti me zjarr kurorëzuar,
Rrebelce kur vërsulet nga zëmra, si skëterrë, —
Na qeshim, se na shfryjmë një dhëmbje të tèrbuar —
Me zjarr e me shkëndira na ndrit fytyrën sterrë.
S'ësht' loti, por ësht' zjarri, që ndizet pér shpagim,
Ësht «ah-u» që ndërsehet nga gjoksi pér çlirim.

2) Timur-lengu, mbreti i tartarëve, personifikimi i tiranit më
të egër, më zëmërgur. Pér të treguar shpirtin gjakpirës të tij.
rrreth tij është thurur kjo legjendë:

Pér t'u hakmarrë kundër vdekjes, e cila i rrëmbeu të birin,
Timur-lengu vriste pa mëshirë me mijra njerës, duke dashur të
lërë kështu mortjen pa viktima dhe pa ushqim, gjersa të vdesë
nga uria. Me eshrat e të vrarëve ai ndërtonte pallate dhe kësh-
tjella.

Vëlla, që qesh i dehur nga dhëmbja e tèrbuar,
Dëgjom', a më dëgjon? Të flas pér tè dëgjuar,
Me fjalën më tè thjeshtë tè zëmrës së kulluar:
«Vështro: anthropofagu më thell' e fut turi'n
«Në zgavër tè kokalles e palcën i hëthim:
«Kokallja jon' e gjallë ja ndezi lakëmin».

II.

Dëgjo, vëlla: Një fat tè dyve ne na lidh
Dhe burri, q'është burrë, fatin vet e zgjidh.
Kush thënka: «Fati ynë s'ndryshon, ësht' i pazgjidhur!»
Por ti vëlla s'e thua një fjalë kaq tè hidhur.
Nepërkat e gjërpjqtë le t'vjellin helm e vrer,
Na kemi rrugën tonë, s'na ha më ky qeder.
Si mundim që tiranin e trashim, e ushqejmë,
Kur mundim që nga gjoksi vullnetin t'ja rrëmbejmë?
Me ç'forca vall' armikun mbi veten madhërojmë?
Me eshtrat, që në fronte me gjak i cimentojmë,
Me gjokset nëpër fronte, si mure prej çeliku,
Me djersën vala lumi në gji' n e njëj çifliku.
Kur na, që s'kemi forca tè vdesim a tè rrojmë,
Tiranit dita ditës na ditët si ja shtojmë?
Xhelatit na ja falim dhe vetes ja mohojmë.
Me krahun ton' or mik na krahun ja foroøjmö.

Me forca po krijojmë na forcat e tiranit
Në gjirin e çiflikut, në ballin e mejdanit, —
Ku derdhet gjaku ynë: stoli, kuror' e fronit, —
Në tymin e fabrikës, pér majmjen e padronit.

Kur na pra, kemi forca një forcë tè ndërtojmë,
Nuk kemi vallë forca na prapë ta rrëzojmë? . . .

Kush thënka: «Fati ynë s'ndryshon, ësht' i pazgjidhur»?
Nepërkat, gjërpérijtë vërvshlljinë gjuhë hidhur...
Na jemi një fuqi, burim i pashteruar;
Na jemi forc e madhe, që s'ka tè krahasuar.
Tirani është një, na jemi qindra plotë;
Na jemi bot' e tërë, që s'duam gjak e lotë.

Na jemi milionë, na jemi miliarda,
Çdo vepër çnjérëzore të pjellave bastarda.
Në gjiret e pafundëm e gjerbim, e përpjimë,
Tiranit ethe-akull e tmerr nér dej i shtjmë.
Na ngrëmë kudo punën në fshat e në qytet,
Na shkrijmë dej e djersë dhe rrojmë pér ibret.
Në detin «Vala djersë» me gjire të uritur,
Padronin e përpjimë, si gjethen e drobitur.
Stolisim na me gjak një fron e një tiran...
Në gjin e këtij gjaku, si det i paliman,
Përmbysim krokodila, demona-lukunira:
Aty ta shëmbin dufin sadistat egërsira.

Nga gjoksi yn' i ndezur, i pastër, qelibar,
Na shfryjmë zémërimin më t'egër thëllimtar
E thajmë çdo tiran të fronit gjakëtar,
Si fryn narrër i ngrirë e than çdo fije bar.
Me frymën që lëshojmë nga zëmr' e zjarrtë «ah»-un
Tiranin na e ngrëmë, si era që ngrë pahun.

Kush thërka: «Fati yn' s'ndryshon, ësht'i pazgjidhur?
Nepërkat e gjerpjtë vishkllijnë gjuhë hidhur...
Por tyj të shoh dhe sot un' të rrepët e krenar,
Ashtu, si qindra herë, me syrin guximtar,
Nér qindra sa beteja pér shekuj luftëtar.

Po ndrit e ardhmja jonë në gas e në stoli:
Ja, popujt se si ngrihen në luftën pér liri;
Vëlla, të shoh ty unë nér fushat e mejdani,
Nga Kina përtet detesh, nér skajet e Ballkanit,
Nga turre nér beteja aq t'egra, madhështore
Se sot Yll' i Kremlinit të prin ty në fitore.
Po ngrihet bot' e tërë, po shkundet si tërmët,
Se shekuj në zinxhirë lëngoi pér kiemet.
Sot koha m'e bukur, që dergjet në kështjellë,
Mbi shtrat të lehonisë, me rreze e re mbështjellë,
Ka muajin e nëntë, ësht' mbarsur e do pjellë.
Përpara pra, vëllako, ashtu si të ka hie,
Përmbyss kudo xhelatë dhe kulla tiranie.

Përpara, ta dërrmojmë vargoin që na lidh,
Sct pem' e fatit tonë s'ka hiç më nj'aguridh,
E sotmja na ndih neve, e ardhmja është e jona,
Dëgjo se si buçasin sot malet nga jehona
Në luftën pér lirinë, që ndezin armët tona.

Kushtrim' i fatit tonë na flet e trumbeton:
«Me luftë zhduket lufta, që popuj skllavëron!»

*) Kjo poezi u shkrua në Mars 1943, në kohën e okupacionit fashist italian. U ripunua më vonë pas çlirimit, më 1951.

LUFTETARI I MARROSUR

I.

Po rënd përpara, rënd në ballin e armikut.
Në flakën e barotit, në majën e çelikut.
Ësht' urdhër i pakthyer, ësht' urdhër' i të parit
Dhe rënd e, kur arrin përpara kundërshtarit.
Pa ditur tek-e-qysh, përlëshet me furi
Dhe pa mëshir' e shpon, i bie me cfungji.
Ahëre, kundërshtari, pa frym' e krejt i vdekur.
I mbytur, i rrëzuar në gjak e ndënë hekur,
Në tokën aq të gjërë një rrugë i liron
Ushtarit të xhindosur, që hidhet e kalon
Kufomën, që ka shtrirë në tokën e paanë
Dhe rënd, e s'di përse, si cjak në kasapanë.
Më tej ai po shkon e s'e mendon aspak
Njeriuun e varrosur në hekur e në gjak,
Për thundrën e vetë kufomën ja ka prak:
E shkel, e kapërcen. Ndërgjegja nuk e shpon
Dhe shtyhet, si i marrë; po ikën e s'mendon:
«Njeriut, që s'e njoh përse t'ja marr un' jetën?
«Përse me gjak të tij ta lyej bajonetën?
«Viktima e panjohur a s'ishte pra njeri,
«Që donte nder e jetë, paqe dhe liri?»
Ai s'gjykon e s'di, që s'di se ç'jetë mori,
Pa ditur ç'zëmër fsheh përbrënda kraharori...
Ç'të keq i kishte bërë? përse e vau? ç'pati?
Ah! s'di se janë shokë, vëllezër të njëj fati.
Si hie po vrapon e ngjan, si një fantomë
E lyer nëpër gjak. E mjera automë!¹⁾
E vall' a mund të dijë ç'e shtyn e ç'e ndërsen
Aty në kasapanë, ku jetën s'e kursen? ...

1) Ka kuptimin e njeriut në lëvizje të pavetëdijëshme.

Di vetëm që kaloi një det e male shumë,
Në tokën krejt të huaj ta derdhë gjakun lumë;
I ndezur, i ndërsyer të vras' e të luftojë.
Me kocka dhe me gjak «Atdheun ta zgjerojë».
Në pamjen e shëmtuar të luftës së xhindosur.
Që zien, si homnerë, ushtari i marrosur,
Ushtari i mizeries, i turpit e i zisë.
Po shtyhet e humbet në mes të mizërisë.

II.

Dhe luftën e fitoi. «Armiku» éshëtë thyer
E tok' e gjërë skuq në gjak njeriu lyer...
Po kthehet në atdhe ushtari i marrosur,
Një krah e ka të thyer e syrin të brengosur.
Ushtari ngadhënjyes po kthehet në shtëpi
Të prëhet e të rrojë në paq' e lumtëri.
Ç'dhuratë do të shpjerë prej luftës së fituar,
Kur foshnja do ta presë me mall të përvëluar,
Kur ky ta përkëdhelë me zjarr në kraharuar,
Dhuratë? vetëm një, oh, krahun e shkurtuar,
Ç'gostira do të gjëjë në strehën këtë radhë?
Gostira vetë strehën për toke një gërmadhë
E mëmën buzë dredhur në kënd të pleqërisë,
Të shoqen e fëmijën të verdhë prej urisë,
Të motrën e pafaj, që humbi virgjérinë
Në luftën, ku për ditë u ndesh me varférinë...
Vëllain: një kufomë llogoreve varrosur
E vetë me një krah prej luftës së xhindosur.

Dhe djali, kur e pa të atin bracë prerë,
Me lotë qau, tha: «Babai im i mjerë,
E ç'u bë krahu yt, që mua më ushqeu?...
Më thuaj, ku e humbe? më thuaj kush ta preu?»
Babai iu përgjegj me dhëmbje ndënë gji:
«E humba për atdhe, për nder e madhëri». [1]
I vogli me lotë mbi faqe rrëkellyer
E pyet: «Po im unj, baba, që s'ësht kthyer?...
Babai pshëritin: «Në luft' o bir, ra fli...
«Luftoi për atdhe, për nder e madhëri».

Sintida shkurt III.

Dhe koha, si tespipet vjetët zvarr i heq
E burra bëhen djemtë dhe burrat bëhen pleq...
I varfëri po mbetet më keq se më parë,
I pasuri po rjep e mbytet në thesarë.

Kur fryn murrër' i egër e bora dhen' e shtron
Në rrugët e qytetit një lypës po kalon,
Një plak, ah! i kërrusur, i thinjur e i mjerë,
Që dridhet nga e ngrira. Një krah e ka të prerë...
Nga syri tij buçet e shfryn një tragedji,
Që vlen sa jet' e tërë, mësim për çdo njeri.
Një dit' i ngrati lypës mbi borë kishte shkarë,
Kur pa t'i shkojë pranë një varg i gjat' ushtarë...
U ngre dhe, duke parë, nga zëmra psherëtiu:
Diçka nga koh' e tij nér mënd i vetëtiu.
E ngjante, sikur lutej ushtarët t'i ndalonte
Diçka nga jet' e tij atyre t'iu tregonte.
Ah! donte t'iu rrëfente me syrin e brengosur
Një dramë temëruar: «Ushtari i marrosur!...»¹⁾

Ashtu, i kërrusur, trastën bosh në dorë,²⁾
Zvarriset, si hie dy çape mbi borë...
Atij s'i rëndon jo, barr' e pleqërisë,
Sa duf i urejtjes kundër skullavërisë.
Qëndron e nga gjoksi shpërthen me tèrbim:
«Mallkim luftë-nxitës, për jetë mallkim!
«Sikur ta fitoja prap un' krahun tim
«Nga ti do kërkoja më t'egérin shpagim!
«Ho! ti më ndërseve në luftra kasapanë,
«Për etjen tënde vrava dhe më vranë.
«Ma kthe xhelat tani ti krahun tim,
«Jetën e risinë, q'ish në lulëzim.

1) Që nga krei gjer tek ky varg është shkruar më 1943.
2) Që nga ky vark gjer në fund u shkrua më 1951.

«Vëllezërit e mij të fatit vrava unë
«Dhe sot lundroj në dallg' e në fortunë.
«Viktimat, që rrëzove ti me krahun tim,
«Nga un' e nga ti kërkojnë shpagim...
«Dhe un' e di: Skllavi rri më pritë
«Lëkurën tënde ta ngrërë ndonjë ditë
«Më tra. Vec u ruaj, ruaju xhelat,
«Pusij' e hakmarrjes s'të lë fort afat,
«Se shpirtin e rrahu n'ibret e n'adhap
«As djajt e skëterrës nuk e bëjnë zap».

E natën, kur strukej aty nën nj'urë,
Ku dridhej, rënkonte ethesh i sëmurë,
I ra prap nér mëndje koh' e djalërisë,
Që veç lulëzoi vetëm pér tiranin,
Kur sot, shpresa tharë, ja, nga kup' e jetës,
Në zëmrën e djegur po gjëlltit shafranin...
Dhe pa ky xhelatin në gjak të përlyer,
Me pluhur kockash mbi fron dëfryer
E pa dhe milionat t'uritur, zëmër plagë,
Q'i sulen xhelatit pér të marrë shpagë...
Ai s'ka sot armë, si dikur në duar,
Po thellë në gjoks urrejtjen e tërbuar
E thell' i zëmruar gulçoi si deti,
U lëkund, si toka, kur e shkund tërmeti
Dhe pa ky vveteten, ndezur nga tërbimi.
Ndërsyer tiranit n'atë ças kushtimi,
Si mij' e miliona para syvet ëndur...
I ri, gji graniti shtyhej duke rëndur
Dhe gjoksin e zbraste, si lavë vullkani:
«Urra! hoo! përpara... ja tek ësht' dushmani.
«Urra, sulm o burra... përpara o shokë,
«Asnjë këmb' armiku të gjallë mbi tokë.
«Dërmoxani froni, çkallmoni pallatin,
«Mbi gjak e kokalle shqyeni xhelatin.

«Urra, hoo! pérpara, pérpara, urra!»
«Lékurën t'ja varim xhelatit më tra.
Dhe rëndte, rëndte pérpara, si dikur...
Por jo më në tokën e huaj pér basti...
Si zjarr shkrepëtinte i kuq një flamur
Mbi krahun e tij të rrepët, si stuhi.
«Liri, buk' e paqe pa luftë s'fitohet...
«Nga ne bot' e vjetër shiko, si tmerrohet!
«Shikoni, si dridhet xhelati... hahaaa!
«Pérpara në flakë, pérpara, urra!»
E duke sulmuar mes bujash e jehonash
Ushtar' i së vërtetës shtyhet e rrëshqet
Në gjiret e detit tallas milionash,
Sa plakut, nën urë, nga syt' i humbet...
Po gjëne flamuri, si një flak' e gjallë,
Akoma po ndrit e prin atje në ballë!...»

KOLLOSI I SHEKUJVE

I

Vargje shekujsh erdh' e shkuan,
 Dacka vreri na dhuruan,
 Me kamzhik na vërshëllyen,
 Dhëmbë-hekur na ndërsyen
 Lava sherri... gjak pikuan.

II

Dridhej toka katër anësh:
 Ngrihej rrepët vegjelia
 Mbi taborr hordhi satanësh,
 Kundër kralash e sultanësh,
 Trandej sulmesh tirania.

III

Shkrepte zjarri si rrufeja,
 Rridhte gjaku si rrëkeja,
 Ndizej qielli tym e flakë:
 E pa thyer, nér bëteja,
 Vegjelia, mirrte hakë.

IV

Mijra vjetë na qëndruam
 Nér beteja shekullore,
 Mijra vjetë trashëguam
 Na mjerimin, q'e luftuam
 Pa shërim e pa fitore.

Po një dit' u ngre Partia
 Reze ndritur nga lavdia
 Dhe na priu për shpëtim,
 Kishte dritën e Kremlinit
 Dhe flamurin e Leninit
 Pala-ëndur në kushtrim.

Syri saja frikë s'dinte,
 Nëpër natë shkrepëtinte
 Edhe çante errësirat.
 Fjal' e saja ishte shpatë,
 Që shkëlqente nëpër natë
 Dhe tmerronte egërsirat.

Edhe mijra pas i vanë
 Gjith t'uritur rreckamanë,
 E i thanë: «Me ty, Parti,
 «Na do vijmë pa kursyer
 «Jetën ton' e të pathyer,
 «Do qëndrojmë në stuhi!»

Edhe turma më nuk priti...
 Ishte ora, kur buçiti
 Fjal' e madhe: «Për liri!»
 Dhe në sulmin, q'e goditi,
 Kull' e beut s'pipëtiti,
 Rrafsh me tokën u bë hi!

IX

Vargje prangash u dërrmuān,
Frone, skeptra u rrëzuan,
Tirania u varros.
Skllavi, ndrysur në zinxhirë,
E drejtoi shta' n e lirë
Përmbi shekuj, si kollos.

REPUBLIKËS SONË

(Këngë)

Ndrin mbi stemën tënde Yll' i 7 Nëndorit:
Ti nga Moska more drít' e madhëri
Dhe sot frym' e jet' i dhe ti kraharorit
Në vargoj dje lidhur, q'u ngre pér liri.

Me ty ligji artë u thur i kulluar:
«Njeriu: mbi tokë m'i shtrënjtë thesar,
«Në bot' as që pati e s'ka gjë më të çmuar
«Asnjë minier ari, a galeri plot ar.»

Ja, kurorën tënde e stolis lavdia,
Mbi 'të ti skalise: «Pér jet» ta gëzojë
«Paqen, socializmin. t'ardhmen vegjelia,
«Atdheun e lirë vet ta lulëzojë.

«Të djeshmen e varrosëm, përpara marshojmë
«E ja, para nesh po ngrihet madhështia
«E jetës së qeshur, që vet e krijojmë:
«Fortesën e paqes ndërton Shqipëria.»

Lavdi e kurorës ësht' fitorja jonë,
Me gjak të heronjve në qindra beteja,
Heronj. q'i dhuruan emër pér gjithmonë
Atdheut, ku ngrihet krenarisht e reja.

Të përdorur nën zhvillimi i njohur vjetor

është që këtë shtet t'i bëjë më shumë se

që ka qenë i përgjithshëm që do t'i bëjë.

Në këtë mënyrë, që do t'i bëjë?

THE NË RRUGËN E LENINIT

Kur dje, në luft' n e madhe për çlirim,
Rërëke ngal gjoksi derdhej gjaku im,¹⁾

Thoshja: «ja liria!»

Dhe sot, kur derdhet djersa si rrëke,
Në luft' për paq, për vet jetën e re,

Them: «ja lumtëria!»

Në rrugën, ku print flamuri Leninit. —
Që shekuj la prapa. — dhe yll' i Kremlinit,

Na prin sot Partia!

— që do t'i bëjë at qëm i ngritjet e
nënëve që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

— që do t'i bëjë at që përfundon —

1) Nënkuptohej që flet goja e popullit.

KËSHITJELË BUZ' ADRIATIKUT

Një Maj — një ditë betejash madhështore,
Ku gjoksin e kalitur në t'egra tufane
Puntori vaditi me gjak për fitore...
Një Maji — një ditë përpjekjesh vigane.

Po! dje ky 1 Maji vinte aqë zymtë,
Një mjegull acari mbështillte natyrën:
I zi në pranverë dukej qiell' i rrymtë,
Gëzim' i jetës e kish humbur ngjyrën.

Por sot 1 Maji s'vjen më të shikojë
Në vëndin tonë t'egrat beteja, —
Ashtu si dikur, — mjerimin e zinë;
Sot vjen të shikojë fitoret e reja,
Që na sjell çdo ditë, paqen, begatinë.

Po vjen pra 1 Maji të shohë tek ne,
Në zemër t'Atdheut, si rreh dhe vërshon
Ky pulsi vigan i jetës së re,
Si ngrihet aqëmbël kënga dhe jehon
Nga gjokset tanë, kudo përmbi dhe;

Si ngrihet kënga, q'i thuret lavdisë,
Kënga, që këndon gëzimin e jetës,
Ajo më e zjarrrta këngë për lirinë,
Nota m'e kulluar, hymni i së vërtetës.

Si qesh diell' i bukur, dita kur agon
E si ai çdo mbrëmje, para se të shkojë,
Për çudi pa shëmbëll, paska bër' zakon, —
Se ligje të reja n'udhëtime vuri, —
Të kthej' syn e zjarrtë dhe të numurojë
Fitoret e reja, që dita na pruri.

Të djeshmen e hidhur na si në vegim
E sjellim nér mënd, kur sot me gëzim
Shikojmë Atdheun në shkëlqim mbështjellë
Nga drit' e Tetorit q'erdh' në vëndin tonë.

Për paqë, socializëm Republika jonë
Buzë Adriatikut ngrihet si kështjelle,

UN' PAQEN DO RUAJ

Aty, përpara statujës «Partizani»,
I heshtur... mahnitur ai po qëndron
Dhe mijrat, që ranë n'alltar zëmër hekur,
Që shekuj me radhë do mbeten pa vdekur,
Me sy të mbërthyer mbi 'të po kundron.
Ajo sa qartë na i flet për beteja,
Ku zjarr' i furri shëm u ndes si rrufeja:
— Këtu para teje më ngriti Partia
Që ty të të flas un' se ç'ësht' madhështia
E atdheut tonë, vet drita dhe liria,
Që ti po gëzon, ç'ësht' forca vigane
E turmës, që turret, si deti n'tufane.

Dëshmoj un' ku ngrihem, sa shum' q'u vadit
Me gjak toka jonë, sa trima ran' fli
Dhe veprën e pavdekur për jet' e skalit
Në vet formën time, q'u ngre si dëshmi.
Në gjirin tim janë sa mijra dëshmorë,
Heronj, — ata ranë me armë në dorë
Q'atdheut t'i thurin dafina-kurorë.
Dhe ja: mijra plagë në gjoksin brënda meje
Burojn' gjak jetdhënës, si ar' i kulluar,
Artere Anteu: — mij' rryma tallazesh,
Më rrahin e digjen, si me zjarr gatuar.
Dhe plagët rrëke, nga gjaku që burojnë,
Në varr e në heshtje dot mua s'më rrëzojnë,
Po veç legjendare, kollose nér shekuj
Figurën time ngrën' e madhërojnë.
Për jet' me guxim un' vdekjen nënshtrova,
Përpara lavdisë pa shpirt e rrëzova.
Kështu, në trup tim pra, — kupton ti tani? —
Janë plot mijra plagë, po mijra stoli:
Sa plagë aq martirë — heronj dhe fitore,
Aq thurje epoperash në zjarr, — përmendore.
Më ngriti sot Partia, si dje, me guxim
Dhe sot si dhe dje un' qëndroj në kushtrim,

Kushtrim dje në luftë për liri t'atdheut,
Kushtrim sot për paqen mbi globin e dheut.
Dhe ti, si gjithmonë qëndro me guxim
Në rojen e paqes, se ti je vrulli im,
Që dje lash pas vetes në zjarr e stuhi: —
Tek ti jam dhe unë, tek un' je dhe ti.

Me krah' n e fuqishëm, në zjarrin e punës,
Ku thyen çdo normë, me gjoksin stolisur
Krejt n'ar, — dekorata, ti paqen do ruash,
Ti, ti vet i dashur, hero i pathyer.
Në zëmër t'atdheut, me ju qëndroj unë
Dhe ty krenarinë në zëmër të zgjuaj!
Dhe syri të riut, përpara statujës,
U ndes i betuar: — «Un' paqen do ruaj!»

Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —

Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —
Un' paqen do ruaj! —

LULET TË MOS THAHEN

1.

Me zërin e mitur tingllin: — «Mirëmbrëma! —
Kur foshnja nga loja na vjen në shtëpi
E qesh, si dhe rrezja, kur merr e puth e ëma,
Që mbush me dhurata për vitin e ri.

2.

— Mama, sot u rrita prap'un' dhe një vit!
— «Po, shpirt, ti po rrite e do bëhesh dhe burrë.
«Se ke vetë partinë, që ty po të rrit,
«Ajo ruan lulet të mos thahen kurrë.

3.

«Nër 5-vjeçarët ti gonxh' do zbërthesh,
«Ashtu si pranvera me ngjyra mbi dhé,
«Ku piqet kalliri dhe paqja buzqesh
«E çan me gaz kënga nér qiej të pa ré.

NAFT' ATDHEUT

(Këngë)

Shpejt u ngre qytet' i ri,
Ja, ku lindi jet' e re:
Ar buron, buron flori
Zëmr' e tokës përbimi dhe.

Nat' e ditë minatori, —
I palodhur, si ai, —
Po kërkon nga gjir' i tokës
Të burojë «ar'i zi».

Dhe me fjalën e Partisë,
Që dha zëmër e i tha:
— «Naft' atdheut sa më shumë!»
Ai thyen çdo kala.

Republikën, që ka ngritur
Do ta bëjë lule e drithë,
Për të dytin vjeçar
Edhe natën e bën ditë.

Qindra puse: qindra gojë,
Mijra metra thellësi
Çan ai që të burojë
Pashterim ar e flori.

TELEGRAME NGA ÇDO ANË

Telegrame nga çdo anë
Po na vijnë në Tiranë,
Vijn' e thonë: «Për ty Parti
«Tejkalojm-o neve planë,
«Dhe për paqen begatinë,
«Që do sjellë puna jonë,
«Për t'i thënë reaksionit:
«Jemi qindra milionë!
«Jemi na një bot' e tërë
«Dhe s'na thyen dot stuhia,
«Përmbi pesë Kontinentet
«Kërkon paqe njërzia!»

Hajde, yll — milion' i pages,
Socializmit dili m'anë,
Mbi armiq't e Republikës
E fitove ti davanë!
Ke Partin' e dashur, trime
Që të prin-ō nér beteja:
Dita ditës përmbi tokë
Lulëzon e qesh e reja!

SHQIPËRIA

Shqipëria trime,
Gerxhe dhe burime,
Zaje dhe liqej,
Gryka dhe lumej,
Që vaditin rrugës
Nëpër ligjërimë. —
Këng' e valle shkumbësh, —
Fusha, gjelbërimë,

Qiej të paanë,
Mbyllur n'arrati,
Rreze ylyberash:
Qiej farfuri.

Shqipëria jonë,
Nëna Shqipëri...
Pyje me blerime,
Male n'arrati.
Male: ezhdërhara, 1)
Difa të kanosur
Ballë çdo dushmani
Dit' e orë sosur.

Shqipëria zonj' e Shqipëria zërë, 2)
Gji-burim-thesarësh, sa një bot' e tërë...
Djemtë ezhdërhara:
Yj në xixëllime.
Vashat evlihara: 3)
Breza nér agime.

1) Ezhdërha, krijesë imagjinare në përrallat e popullit me fuqi të pakrahasueshme mbinatyrore.

2) Shqipëria — zërë, trime si zëra, përdoret në krahinat e jugut, me kuptimin zanë (gegërisht).

3) Evlihara — ëngjëj.

Arm' e sa fitoresh,
Mbi çdo val' askeri,
Që vjen të bastisë
Dhe mbi ballin nderi,
Ndizen, llamburijnë
Rreze ylyberi
Zëri nëpër erë:
Krism' e bubullimë,
Syri: zjarr rrufeje,
Fjala: tersëllimë.

Tiranë, Maj 1946

«FLET VARSHAVA!» GJITHË THONË

Qeshi dielli rreze artë
Mbi Varshavën kryelartë:
Fjala «Paqe!» lark u ndie
Rreze drite, mbi çdo hie.

U hap lajmi, mori dhenë,
Kaloi male, kaloi dete:
Sot u mblohdhën në Varshavë
tetë popuj, tetë shtete.

Dhe flamurët u valvitën,
Mu si tetë yje ndritën,
Që ta grisin errësirën,
Të dhurojnë kudo dritën.

Ylli i paqes ndrin mbi popuj!
— «Flet Varshava!» — gjithë thonë.
Dhe me gojëne Varshavë
Flasin qindra-milionë:

— «Na kurorë i thurim jetës
«Jemi drid’ e së vërtetës.
«Gjokse, mure prej çeliku
«Jemi na; s’na trëmb armiku.
«Vdekja dridhet e s’guxon
«Të na prekë — e zë paniku.

«Që nga Moska në Berlin,
«Që nga Praga në Tiranë
«Ngrihet shkëmb kalaj’ e paqes,
«Gaz për popujt anemanë.

«Kundër sherrit Kin' e madhe
«Rri mburojë tok me ne...
«Dita ditës forcat tona
«Lulézojnë përmbi dhe.

«Zëmër hapur na i presim
«Miqt e paqes, nga çdo anë,
«Të përbysim çdo pusi,
«Çdo kompllot e kasapanë.»

Thell' me gaz rreh zëmr' e gjérë, —
Gjoks' i math i botës tërë. —

Nxihet zëmër e gangsterit
Prej marazit e qederit,
Se në faqe t'historisë
Shikon fundin e Hitlerit

Dhe, nga kthetërat me gande
Përmbi vise të mëdha,
Sheh se plane stërgjigande
Rrokullisen për hata!...

Pakte e kurthe djallëzore,
Që kurdisi... për çudi,
Ja, sikur i rrëkëllehen
Në homnerë pa kufi.

Yll' i Paqes ndrin mbi popuj!
«Flet Varshava!» — gjithë thonë
Dhe me gojën e Varshavës
Flasin qindra-milionë!

KËNDÖJMË MIQËSINË

Na sot miqësinë po këndoym' o shokë,
Që shpresa të reja lulzoi mbi tokë,
Dëshirat dhe ëndrrat tona shekullore
Në jet' na i ktheu flamur e fitore.

Kushtrim i lirisë për ne që Rusia,
Për krah si vëllezër na kemi luftuar
Nër fusha betejash u lind miqësia.
Burim energjirash, që s'ka të shteruar.

Dhe kur n'atdhe'n tonë lufta anemanë
U ndes mbi fashistat, Moskën kishim pranë
Dhe rrezj' e Kremlinit erdhí të na ndrijë,
Flamuri Leninit u ngre të na prijë.

Në zjarrin e luftës fshatari e puntori
Për Moskën kënduan dje këngën e lavdisë
Dhe sot si dhe dje sulmuesi e novatori
Për jetë po i thurin këngën miqësisë.

Na popuj vëllezër të pathyeshëm jemi,
Të dy në një rrymë me guxim lundrojmë,
Lavdi dhe fitore të pandara kemi,
Liman komunizmin, drejt të cilit shkojmë.

«TITANI I KUQ»

Atje, nér akuj
e stepa tē Rusisë
u ngre kollos çekani proletarit
e rrokullisi
frone,

rrasputinë,
shëmbi borgjezinë.
Varrosi pér jetë
mizerjen,
që sundonte,
pér jet' e ngjalli
jetën që lëngonte.

Në farkën
e gjenive
tē revolucionit.

si një vigan
u shpall
ushtari kuq
me rrëmba tē tendosur.
Në krah' n e tij,
si ylli, zjarr u ndes,
si brez' i agimit

Lindjes
Flamur i Kuq
i math
i Vegjëlisë.

Mbi
globin e dheut
u ënd
shkëlqimi i tij
nér breza ylberi

i arratisur

dhe projektoi
refleksin

e çdo ngjyre

nër

skllevët

në turmat,
ku mjerimi
për jet' e shekuj pati ngrehur fronin. —
selin e kuqe

me gjak e kokalle: —
nër popuj.

ku virtyti

gjunjëzohej

vesit...

E,

kur

sëpata

dhe kryqi i thyer

rrëzuan,

mbërthyen

shtete

nacione;

e kur

murtaja

u shpif

mbi kontinente,

kur krrusi

zija

popuj edhe frone:

Kur tinëz u fandaks

i zi

anthropofagu

i krejt njërzimit

dhe paqes në botë,

oreksin çelur

me gjak

e viktima

dhe i pashëmbur
n'ryryshin e tèrbuar,
u turr nga Lindja
n'akuj,
në kallkane
për të përpirë — hej! —
burim' n e dritës!...
Ushtari Kuq!

Titani Kuq
i kohës,
si prijës i pathyer
në krye miliunësh,
si pararoj¹⁾ e paqes
përmbi tokë
i tha:
«T'erdhi fundi!

Ora të troket!
në vesh ta këndoi

djalli zi
Salanë 1)!...»

Dhe s'qe
fjal' e tij
veç krahu, që u ngrit
i rënd' armatosur
drapër

E nisi aty
përleshja titanike

me gjak e hekur
nër akuj

oqean.
Qëniet malukate të sherrit
u çartosnë,
Titanat e kuq
u ngrysn'
e u sertosnë,

1) Salaja që jep hoxha majë minaresë lajmëron vdekjen
dikujt.

Kallkanet

e thellë
gjerbën afsh e gjak:
vargje miljunësh,
hordhi pas hordhirash
me kryqin
e thyer,
aty u varrosnë!
u shëmbnë!
u çfarosnë!...

Ushtari Kuq!

Titani Kuq!

nga vatr' e tij,
nga toka nënë,
nga tok' e shënjt' e proletarit
i flaku jasht'
hordhit e zeza,
hordhit e hurit
e të litarit.

Po nat' e zezë,

Nga Tuna dhe Ballkani,
në Vjen' e në Varshavë,
në Francë,

n'Iberi,
në tokat e Balltikut
në gjiret

Skandinavë,
akoma buron hie
Dhe vjell lëngata sherri
e shfrym murtaj' e zi.
Dhe ja,

Ushtari Kuq
s'e preu më yryshin...
Me gjak e shoi sherrin
Kudo që zgjati krahun.
Kudo dhuroi paqe
dhe jet' e
brogori.

Dhe ja, mu në Berlin,
ku qe burimi i natës,
burim' i zis' e çerdha
e sherrit, e lengatës,
e ndal stuhin e vrullit
dhe ënd aty mbi 'të
flamurin, — gjak i kuq!
Flamurin gjî vigan
të ndritur
në fitore.
Dhe botës anemanë,
Nga lind e perëndon,
Që hesht e po dëgjon
Me gaz e admirim,
Kështu i trumbeton:
«Jam pararoja
e botës
«përmbi tokë!
«Jam garancia
e paqes
«përmbi tokë!
«Un' jam
Ushtari Kuq!
Titani Kuq!»

Tiranë, Shkurt 1946

USHTRISË SONE

1

Me flamarin e lirisë,
Ti, në farkën e Partisë,
U kalite gji graniti
Mbi vargojt e tiranisë.

2

Ti u linde nér tufane,
Nga mjerimi e varfëria
Dhe nga burgjet e litari,
Ti u linde nga mëria

3

Dhe nga gjoksi plot urejtje
Në përleshje e demostrata,
Nga rrebesch' i zëmërimit,
Që shpërthente në shtërngata...

4

Nga njësite guerrilesh
Tankut hedhur kraharorin
Si kala, që thur legjenda
Dhe lavdi, si 10 Tetorin.¹⁾

1) 10 Tatori është legjenda dhe lavdia, të cilën ja thuri epopezë sonë Nac. që këndon me një komunist si Vojo Kushi.

Ti u linde dhe u rrite
 Nëpër çeta e bataliona,
 Në brigada, mbi armikun~~PRILËP~~
 Lark, kudo t'u ndje jehona.

Thundrës s'egër të fashizmit
 I the: «Ndalu! se jam zot!
 «Se ky vënd, ku vë ti çizmen,
 «Ta bën varrin këtu sot!»

Dhe u ndeshë: U droth toka...
 Qielli: natë Shënëndreu,
 Po nga Moska derdhej drita.
 Që ty rrugën ta rrëfeu.

Armë s'kishje, i fitove:
 Nuk iu trëmbe kurr' rrezikut,
 Ti, me gjak, mortaj' e topa,
 I rrëmbeve prej armikut.

Po me gojë nuk rrëfahet,
 Si qëndroi gjivigan
 Në stuhira dhe rremete
 Legjendari Partizan!

Si kaloi nëpër male
 Dimrin, borën, e stuhitë,
 Si harroi gjum' e prëhje
 Në marshime net' e ditë.

Si gëlltiti gjak e hekur,
 Zjarr për etjen dhe urinë,
 Shtatit plagët: kroje gjaku,
 Gjoksin shkëmb mbi tiraninë.

Ushtri, pjell' e vegjëlisë,
 Ti s'qe arma që luftove
 Për satrapë: banda «krerësh»,
 Ti qe arma, q'i dërrmove.

Shëmbe natën: ndrite shekuj...
 Mijra shok' atje n'alltar
 Nga lavdia ndrijn' e digjen
 Zjarre yjesh rreze ar.

Epopeja, që skalise
 Ngjyrë gjaku e zjarri n'hekur,
 Do këndohet, si një hymën
 Legjendarësh të pavdekur.

Ty lavdi për jet' ushtri!
 Republikës i del zot;
 Në kufi, në tok' e det,
 Këmb' armiku nuk bën dot.

Paqen ruaj, mbro fitoret! *16*
 Ti s'je vetém sot mbi tokë, *17*
 Ke Varshavën që të dha *18*
 Me qindra miliona shokë. *19*

Qërshor, 1955

—
16 —
 Paqen ruaj, mbro fitoret!
17 —
 Ti s'je vetém sot mbi tokë,
18 —
 Ke Varshavën që të dha
19 —
 Me qindra miliona shokë.

—
20 —
 Qëndroj, qëndroj, qëndroj,
21 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
22 —
 Dëshironi këtë qëndrë, dëshironi
23 —
 Dëshironi qëndrën e përgatitur.
24 —

—
25 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
26 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
27 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
28 —
 Nëpër qendrën e përgatitur.

—
29 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
30 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
31 —
 Nëpër qendrën e përgatitur,
32 —
 Nëpër qendrën e përgatitur.

TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
1. Në sferat më të larta — Beteja dhe ngadhënje	3
2. Një fjalë	5
3. Ç'i rrëfen flamuri erës	6
4. Kështjella e krahatarit	9
5. Në varr e në triumf	12
6. Mbi gjakun e dëshmorit	16
7. Dhëmbje e krenari	20
8. Marsh partizan	22
9. Na prin Partia	24
10. Legjenda jonë — Me ne Lenini, Moska dhe fitoja — (Rapsodi)	26
11. Vëllezër të njëj fati — Të ftoj vëlla	31
12. Luftëtar i marrosur	36
13. Kollosi i shekujve	41
14. Republikës sonë	44
15. Në rrugën e Leninit	45
16. Kështjellë buzë Adriatikut	46
17. Un' paqen do ruaj	48
18. Lulet të mos thahen	50
19. Naftë atdheut	51
20. Telegrame nga çdo anë	52
21. Shqipëria	53
22. «Flet Varshava» — gjithë thonë	55
23. Këndojojmë miqësinë	57
24. Titani i kuq	58
25. Ushtrisë sonë	63